



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura V**

Sesioni pranveror

**Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport**

Mbledhja nr.83

Prishtinë, më 4.4.2017, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-I

**PROCESVERBAL**

**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ARSIM, SHKENCË, TEKNOLOGJI,  
KULTURË, RINI DHE SPORT**

**Në mbledhje morën pjesë:** Nait Hasani, kryetar, Salih Morina, Ismajl Kurteshi, Shpejtim Bulliqi, Teuta Haxhiu, Shukrije Bytyqi, Bekim Haxhiu dhe Mufera Shinik.

**Mungoi:** Sërgjan Popoviq.

**Përfaqësues të ftuar:** Ramë Vataj, Rektor i Universitetit të Prizrenit “Ukshin Hoti” dhe Arben Podvorica

**Përfaqësues të tjerë:**

**Stafi Mbështetës i Komisionit:** Lule Ymeri dhe Shaip Goxhuli

**Mbledhjen e kryesoi Nait Hasani, kryetar i Komisionit.**

**Për këtë mbledhje u propozua ky**

**Rend i ditës:**

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 20.3.2017;**
- 3. Shqyrtimi i propozimit për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Universitetit “Ukshin Hoti” në Prizren;**
- 4. Të ndryshme.**

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

### **1. Miratimi i rendit të ditës**

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

### **2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 20.3.2017**

Anëtarët e Komisionit miratuan pa vërejtje procesverbalin nga mbledhja e kaluar.

### **3. Shqyrtimi i propozimit për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Universitetit “Ukshin Hoti” në Prizren;**

Nait Hasani, në fillim të mbledhjes tha se Komisioni gjatë muajit mars ka pranuar një kërkesë nga Universiteti i Prizrenit, kërkesë kjo e mbështetur nga Ministria e Arsimit. Ai njoftoi anëtarët e Komisionit me vërejtjet dhe kërkesën për ndryshim dhe plotësim të Statutit të Universitetit të Prizrenit, si pasojë e pamundësisë që kjo të bëhet përmes plotësim-ndryshimit të Ligjit për Arsimin e Lartë, ligj ky që kërkon votën e 2/3 e dyfishhtë të deputetëve të Kuvendit.

Rektori i Universitetit “Ukshin Hoti”, Ramë Vata, falenderojë komisionin për procedimin e shpejtë të kërkesës së paraqitur me plotësim ndryshimet në Statut. Ai tha se pasi që ka marrë udhëheqjen e Universitetit, ka vërejtur problemet dhe ngecjet në zbatimin e Statutit, se në Konferencën e Rektorëve, kanë paraqitur shqetësimet dhe vërejtjet në lidhje me Statutet e Universiteteve Publike. Në vazhdim të diskutimit të tij, ai theksoi se janë sugjeruar dhe mbështetur nga Ministri i Arsimit, që të sillen propozimet për plotësim ndryshime, pasi që ndryshimet në Ligjin për Arsimin e Lartë tani për tani janë vështirë të realizueshme. Ai arsyetoi kërkesën për ndryshimet dhe plotësimet në Statut, me faktin e rritjes së Universitetit dhe tha se është e domosdoshme të kemi kritere të njëjta me të gjitha Universitetet Publike sa i përket avancimeve të stafit akademik.

Më tej foli për propozimin për angazhimin e Asistentëve Ligjërues duke e arsyetuar si të nevojshme legjitimimin e tyre në mungesë të stafit akademik dhe numrit në rritje të studentëve dhe rritjen e numrit të përfaqësuesve në Senat, pasi që është rritur edhe numri i studentëve. Rektori Vata, prezentoj propozimin për legjitimimin e afateve të provimeve, atë të Prillit dhe Nëntorit, duke shtuar se edhe ashtu në praktikë janë duke e bërë por që nuk është e paraparë me Statut.

Nait Hasani, tha se për të siguruar Universitete të Pavarura, udhëheqësja e bordit të Universitetit duhet të jetë nga Universiteti dhe jo nga Ministria, ashtu siç është tani. Një çështje tjetër e ngritur pati të bënte me kufizimin e moshës për angazhimin e asistentëve si dhe deshi të dijë se a janë në konflikt me angazhimet e brendshme të asistentëve ligjërues.

Ramë Vata sqaroi se kryesuesi i bordit është i precizuar me ligj, ku thuhet se udhëheqësi dhe zëvendësi i bordit nuk mund të jenë drejtpërdrejt të angazhuar si punëtor të Universitetit. Ndërkaq, sa i përket angazhimit të asistentëve dhe kufizimit të moshës, ai tha se këtu bëjmë shkelje të butë të ligjit, duke e arsyetuar me mungesën e kapaciteteve për angazhime të reja.

Shukrije Bytyqi, në fjalën e saj tha se do të bëjnë plotësimet dhe ndryshimet më të mira dhe të nevojshme të Statutit, zbatimi i të cilit do të ishte në të mirë të të gjithëve. Ajo tha se në realitet Universitetet nuk janë të pavarura, kur marrim parasysh anëtarët që delegon Ministria. Një shqetësim i ngitur kishte të bënte me zgjidhjen e problemit më studentët e diplomuar në Fakultetin e Edukimit, në programet që nuk kanë qenë të akredituara. Më tej ajo shtoi se çështja e angazhimit të kuadrove të rinjë po keqpërdoret nga të gjitha Universitetet Publike dhe se arsytimi i rektorëve për këto çështje janë banale, pasi që ka kuadro të rinjë mjaftë të zot po që nuk po u ipet mundësia e angazhimit në Universitetet tona. Ajo tha se ka rast konkret, kur janë shkelur kriteret dhe u është mohuar e drejta për angazhim në këtë Universitet dhe se këtë e mbështet në materialet të cilat mund t'i ndajë më të gjithë.

Teuta Haxhiu, paraqiti shqetësimin e saj në lidhje me tërheqjen e Ligjit të Arsimit të Lartë duke theksuar se në mungesë të ndryshimeve të nevojshme në Ligj, po krijohen vështirësi edhe në plotësim ndryshimet e Statuteve të Universiteteve Publike. Ajo tha se i qëndron prapa kërkesës së saj që së pari të ndryshohet dhe plotësohet Ligji, pastaj komfor tij, të harmonizohen edhe Statutet. Haxhiu tha se angazhohet që të kemi pavarësi të plotë të Universiteteve dhe theksoi që propozimet për ndryshime të neneve të Statutit të Universitetit të Prizrenit, janë me arsytimin për të realizuar punë por që shtoi se është kundër uljes së kriterëve të parapara me ligj dhe statut.

Shpejtim Bulliqi në fjalën e tij tha se është koha që të ndryshohen dhe plotësohen të gjitha Statutet e Universiteteve Publike pasi që kanë një sërë mangësish dhe ka të atilla që janë në kundërshtim me Ligjin e Arsimit të Lartë. Ai ngriti shqetësimin e tij në lidhje më disa nga propozimet e paraqitura duke thënë se ka mundësi që të vazhdojnë të mbesin të hapura. Më tej ai shtoi se pavarësisht kufizimit të punimeve shkencore me periudhën kohore pas zgjedhjes, pra, jo total, por pas zgjedhjes së fundit, vazhdojnë të paraqiten probleme sa i përket avancimeve akademike. Ai më tej tha se ende nuk është qartësuar se çka ngërthen në vete me punim shkencor, dhe se kjo po krijon paqartësi dhe se rekomandimi i nxjerr nga vet Universiteti i Prishtinës, ka krijuar vështirësi në zbatimin e tij. Më tej tha se edhe ai është ithtar që së pari të plotësohet dhe ndryshohet Ligji për Arsimin e Lartë, e më pastaj të bëhen ndryshimet e nevojshme të Statuteve, por që një gjë e tillë po has në pengesa evidente. Ai kërkoi sqarime shtesë sa i përket Asistentëve ligjërues duke kërkuar të dijë së cili është titulli i tyre shkencor. Bulliqi shtoi se do të ishte më mirë që të kemi gradën e ligjëruesit ashtu siç ka qenë më parë dhe të mos potencohet që duhet ta ketë domosdoshmërisht doktoratën e përfunduar.

Në këtë pikë, Rektori Vata tha se me pozitën e asistentit ligjërues kanë menduar t'i legjitimojnë ata të cilët janë të angazhuar në Universitet dhe se me këtë kanë nënkuptuar asistentët e rregullt të cilët janë në përfundim të doktoraturës por që ata do të jenë në mbikëqyrje të bartësit të lëndës.

Salih Morina shprehu interesimin që të dijë se cili është kualifikimi me të cilin janë përzgjedhur asistentët e rregullt dhe ata me angazhim në Universitetin “Ukshin Hoti”, për të cilën morri përgjigjen se nuk ka asnjë asistent që punon në Universitet e të mos e ketë titullin Master.

Bekim Haxhiu përshëndeti hapin e ndërmarr nga Universiteti “Ukshin Hoti” për plotësim ndryshimet në Statut. Ai tha se një vendim i gjykatës ka nxjerr vendim që të gjitha Statutet e Universiteteve Publike duhet të jenë konform Kushtetutës. Ai njoftoi të pranishmit se vendimi i gjykatës sa i përket kufizimit të moshës për ligjërimit, është në kundërshtim me Kushtetutën e Kosovës dhe me Ligjin për Procedurë Administrative, pasi që sipas arsytimit të tyre, kushdo prej moshës 18 deri 65 vjet ka të drejtë të krijimit të marrëdhënies së punës. Ai shtoi se duhet të ketë uniformitet et sa i përket kritereve të avancimeve, publikimeve, zgjedhjeve, njohjes së punimeve dhe prezantimit të tyre në Kongrese të mëdha Botërore etj, dhe pyeti pse Universitetet po i shmangën konkurrencës si dhe ngriti çështjen e njohës së revistave ndërkombëtare.

Më tej tha se titulli për pozitën asistent ligjërues nuk është i paraparë as me Statut e as me Ligjin për Arsimin e Lartë dhe si i tillë nuk mund të zbatohet nga asnjë Universitet. Ai tha se duhet të diskutojmë ndryshimet dhe plotësimet e nevojshme të të gjitha Universiteteve Publike, pasi që ata nuk duhet të jenë tërësisht të ndryshme nga njëra tjetra, por që duhet të bëhen konform specifikave të tyre si dhe shtoi që Universitetet duhet të profilizohen. Haxhiu theksoi se detyrë e Komisionit është të angazhohet për cilësi, mbarëvajtje dhe ngritjes së cilësisë në Arsimin Publik dhe të sigurojë konkurruesmëri të denjë më Arsimin e Lartë Privat.

Mufera Shinik, tha se është mirë që Komisioni të ftojë Ministrin e Arsimit dhe të gjithë Rektorët e Universiteteve Publike për të diskutuar për Ligjin e Arsimit të Lartë dhe konform tij të bëhen ndryshimet dhe plotësimet e nevojshme në Statutet e Universiteteve Publike. Ajo shtoi se do të ishte mirë që të themelohet drejtimi për Turizëm dhe Shëndetësi, pasi që në Kosovë ka mundësi të mira për zhvillimin e kësaj fushe.

Ismajl Kurteshi në fjalën e tij tha se në parim pajtohet me parafolësit, duke thënë se së pari do të duhej të ndryshohej Ligji për Arsimin e Lartë dhe më pastaj, përmbajtja e Statuteve të Universiteteve Publike njëherazi pasi që problemet me të cilat ballafaqohen ato janë të përbashkëta, duke thënë se ndoshta disa specifika do të mund të mbeten të ndryshme njëra prej tjetrës. Ai tha se para se këto ndryshime të bëhen, të analizohen dhe të shikohet nëse këto kërkesa për ndryshime janë të bazuara në Ligj, në të kundërtën, çkado që do të dilte përtej ligjit, për neve si Komision do të duhej të ishte e papranueshme. Ai e vlerësoi si të padrejtë kërkesën e Rektorit që Profesori Asistent të jetë në pozitë menaxhuese, pasi që sipas tij kjo do të përbënte konflikt interesi. Krejt në fund ai tha se iu dukë interesante formulimi të cilin e përdori Rektori sa i përket ‘shkeljes së butë’ të cilin e cilësoi si të papranueshëm shkeljen e ligjit.

Rektori Vata u përgjigj në çështjet e ngritura nga anëtarët e Komisionit. Ai tha se do të duhej të organizohej një takim më të gjithë rektorët e Universiteteve Publike dhe të diskutonim gjerësisht për të gjitha çështjet dhe problemet që hasim në fushën e Arsimit të Lartë. Vata shtoi se

akreditimi i programeve në vitin 2011-12 në Fakultetin e Edukimit në Prishtinë, si dhe degët e saj në Prizren, Gjakovë e Gjilan, nuk ka qenë kriter stafi akademik që nënkupton tre vet për program. Ai tha se këto programe janë bartur me vendim të Ministrit dhe se studentëve që po dëshirojnë të dalin jashtë Kosovës për studime, po u del problem me nostrifikimin e diplomave pasi që po mungon vendimi i Agjencionit të Akreditimit. Ai tha se me shkelje të butë të ligjit nënkupton se ai nuk jep kontratë të rregullt por angazhohet dhe se nuk është asgjë e dëmshme që angazhohet dikush për të realizuar mësimin.

Më tej, theksoi se çdo gjashtë muaj realizohet një vlerësim i brendshëm anonim për të gjithë mësimdhënësit aty dhe tha se u japim mundësi të pakta të angazhuarve të rinjë, dhe nëse ata tregojnë performancë të mirë, mund të angazhohen përsëri. Vata tha se duhet të ketë vendosje të kriterit të moshës sepse nuk mund të jenë inovativ një i ri dhe një mbi të 50-ve. Ai edhe njëherë theksoi se shkeljen e butë të ligjit e bënë tek angazhimet sepse është e domosdoshme mbajtja me rregull e orëve të mësimin dhe shtoi se për këtë iu është lehtësuar kjo problematikë, me marrëveshjen që kanë mes Universiteteve Publike në vend.

#### **4. Të ndryshme;**

Anëtarët e Komisionit vendosën që në mbledhjen e datës 18 prill të diskutohet për Statutet e Universiteteve Publike dhe se për këtë të ftohen të gjithë rektorët e Universiteteve Publike si dhe Kryetari i Agjencionit të Akreditimit.

Ismajl Kurteshi propozoi që të realizojnë vizitë në Gjimnazin Matematikor, pasi që sipas tij, ata po ballafaqohen me probleme të shumta. Qëllimi i kësaj vizite është të njihen nga afër për të gjitha problemet dhe procesin e mbarëvajtjes së mësimin.

Një propozim tjetër ishte që të ftohet fituesja e Medaljes së Artë Olimpikë në Xhudo, Majlinda Kelmendi.

Mbledhja përfundoi në orën 11:45

***E Përgatiti:***

***Njësia për Mbështetjen e Komisionit***

Kryetari i Komisionit,

-----

Nait Hasani